

LIGJ
Nr.9667, datë 29.12.2006

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.7796, DATË 17.2.1994 “LIGJI
MINERAR I SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.7796, datë 17.2.1994 “Ligji mineral i Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Kudo në ligj emërtimi “Drejtoria e Përgjithshme e Minierave” zëvendësohet me emërtimin “Struktura përgjegjëse në ministrinë që mbulon veprimtarinë minerare.”.

Neni 2

Në fund të nenit 3 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Monitorim postmineral” nënkupton një proces për vëzhgimin dhe kontrollin e ndryshimit të parametrave fiziografikë, kimikë, gjeoteknikë, si dhe për vlerësimin e efekteve të mundshme të shfrytëzimit mineral, pas mbylljes ose braktisjes së një miniere.”.

Neni 3

Paragrafi i dytë i nenit 16 ndryshohet si më poshtë:

“Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore është enti i specializuar, i cili siguron asistencë teknike për ministrinë, nëpërmjet oponencave, monitorimeve dhe veprimtarive të tjera, që kanë lidhje me këtë ligj.”.

Neni 4

Neni 20 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 20

Veprimtaria minerare, në tërësi, që lidhet me projektimin, vlerësimin, këshillimin, monitorimin dhe drejtimin teknik të shoqërive, kryhet nga specialistë të pajisur me leje nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, sipas kriterëve të miratuara nga Këshilli i Ministrave.”.

Neni 5

Në nenin 99, pas shkronjës “b” shtohet shkronja “c” me këtë përmbajtje:

“c. zonat minerare, veprimtaria minerare e të cilave vlerësohet e përfunduar apo e braktisur, kalojnë në procesin e monitorimit postmineral. Mënyra dhe kriteret për realizimin e këtij procesi përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekreten nr.5183, datë 12.1.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu